



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.627/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Hilmi Hoxha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e parashtruara nga Hilmi Hoxha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me shenjën ZL.Anr.627/2017, ZL.Anr.629/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.627/2017, ZL.Anr.629/2017 me datë 09.11.2017 nga Hilmi Hoxha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në këto Qendra të Votimit: në fshatin Gllamnik, Qendrat e Votimit 1812e/01R, 1812e/02R, 1812e/03D, në fshatin Lluzhan Qendrat e Votimit 1803e/02R, Bellopoj 1823e/01R, Sekiraçë 1825e/01R, Ballovc 1829e 02D, 01R, në fshatin Shajkovc 1813e 01R dhe 02D në fshatin Peran 1841e dhe 1841e 02D në fshatin Sfeqël 1814e 01R, 1814 02D, në fshatin Llugë 1834 01R, 1834e 02D.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me shenjën ZL.Anr.627/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në ankesat e parashtruara nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet e lartëcekura, po ashtu në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.627/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*